



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Tetor 2021

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Tetor 2021

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në edicionin e përmuajshëm të këtij buletini pasqyrohen aktivitetet për muajin tetor të vitit 2021)

Kërkohet përkushtim për zvogëlimin e numrit të lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike

Anëtarët e Grupit punues për mbikëqyrjen e Njësitit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike janë takuar me Udhëheqësin e Njësitit për Krime Ekonomike dhe Korrupsion dhe Udhëheqësen e Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore të Prishtinës, me ç'rast kërkuan një përkushtim më të madh në zvogëlimin e numrit të lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike dhe trajtimin e tyre me prioritet të lartë.



Komisioni për Administrimin e Prokurorive viziton Prokurorinë Themelore të Gjakovës

Në kuadër të monitorimit të proceseve të punës nëpër prokuroritë e vendit, Komisioni për Administrimin e Prokurorive bëri vizitën e radhës në Prokurorinë Themelore të Gjakovës, me ç'rast, ndër të tjera, ka diskutuar çështje të ndryshme, si: regjistrat e lëndëve dhe harmonizimin e tyre, përdorimi i plotë i SMIL-it nga prokurorët dhe unifikimi i akteve të prokurorëve dhe shkresave të lëndëve, si dhe zbatueshmërinë konkrete

të udhëzimeve të Kryeprokurorit të Shtetit.



Trajtimi i lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike të jetë prioritet i Prokurorisë Themelore të Gjakovës

Grupi punues për mbikëqyrjen e Njësitit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike vizitoi Prokurorinë Themelore të Gjakovës, ku diskutoi raportet e punës së kësaj prokurorie, me theks të veçantë në shqyrtimin e lëndëve të korrupsionit dhe



krimeve ekonomike dhe sfidat në kryerjen e këtyre lëndëve, si dhe prezantoi të dhënat nga raportimi në Këshillin Prokurorial të Kosovës për veprat penale të krimeve ekonomike dhe korrupsionit për periudhën janar-qershor 2021, duke kërkuar një përkushtim më të madh në zvogëlimin e numrit të lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike dhe trajtimin e tyre të ketë prioritet të lartë.

Mbahet takimi i parë i Grupit punues për hartimin e Draftregullore për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit

Grupi punues për hartimin e Rregullore për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit mbahti takimin e tij të parë, në të cilin diskutoi për metodologjinë e punës dhe për temat që duhet të trajtohen nga ky grup punues, si dhe identifikoi çështjet

relevante për punën e Prokurorit të Shtetit, të cilat duhet të përfshihen në draftregullore, përmes së cilës synohet adresimi i sfidave aktuale dhe avancimi i mëtutjeshëm i punës së institucionit të Prokurorit të Shtetit.



Mbahet një takim urgjent i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës zhvilloi një takim urgjent, i 204-ti me radhë, në të cilën themeloi Panelin hetimor për rastin e një prokurori në Prokurorinë Themelore në Pejë.



Lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike të jenë prioritet i trajtimit nga Prokuroria Themelore e Gjilanit dhe e Ferizajt

Grupi punues për mbikëqyrjen e Njësitit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike ka zhvilluar vizitat e radhës në Prokurorinë Themelore të Gjilanit dhe Prokurorinë Themelore të Ferizajt, me ç'rast diskutuan raportet e punës së këtyre prokurorive, me theks të veçantë në shqyrtimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, si ka prezantuar raportimin në Këshillin Prokurorial të Kosovës për veprat penale të krimeve ekonomike dhe korrupsionit për periudhën janar-qershor 2021. Rrjedhimisht, në fund të takimit, u kërkuar që të ketë një përkushtim më të madh, në mënyrë që të zvogëlohet numri i lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, ndërsa trajtimi i tyre të ketë prioritet të lartë.



Deklaratë e Këshillit Prokurorial dhe Prokurorit të Shtetit

Këshilli Prokurorial i Kosovës është shprehur thellësisht i shqetësuar nga deklaratat e Zëvendësministrit të Drejtësisë, Blerim Sallahu, të bëra përmes një statusi në Facebook, ku i quan prokurorët kriminelë.

Deklaratat e Zëvendësministrit të Drejtësisë janë liquese, tendencioze, paragjyquese dhe kanë për qëllim dëmtimin e sistemit prokurorial.

Nëse pushteti ekzekutiv nuk distancohet nga deklaratat e tilla do të ndërpritet çfarëdo komunikimi dhe bashkëpunimi ndërinstytucional.



Ndërkaq, Prokurori i Shtetit siguron opinionin se do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore lidhur me pretendimet e paraqitura në media dhe çfarëdo shkeljeje eventuale do të këtë reagime ligjore.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, si organ i pavarur kushtetues, nuk ka lejuar dhe nuk do të lejojë asnjë interferim nga askush për çfarëdo interesi personal, grupor apo politik të cenojë integritetin e sistemit prokurorial.

Komunikatë për media

Në një komunikatë për media të KPK-së, thuhet: "Përkundër bashkëpunimit të deritanishëm reciprok në procese të ndryshme me Ministrinë e Drejtësisë, siç janë: rishikimi funksional, procesi i vetingut në sistemin e drejtësisë dhe shprehjes së vullnetit të mirë të sistemit prokurorial për ta forcuar bashkëpunimin në avancim të sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës, deklaratat e

fundit, të bëra nga Zëvendësministri i Drejtësisë, i cili i ka quajtur prokurorët të involvuar në veprimtari kriminale, e bëjnë të pamundur bashkëpunimin ndërinstytucional.

Andaj, në takimin e sotëm të Grupit punues për ndryshime ligjore të Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësuesit e sistemit prokurorial kanë kërkuar nga pushteti ekzekutiv, respektivisht nga Ministria e Drejtësisë që të distancohet nga deklaratat e zëvendësministrit, distancim ky, që do t'i hapte rrugë bashkëpunimit dhe respektit të ndërsjellë institucional.

Pas deklarimeve të qëndrimeve dhe mosreagimit nga Ministria e Drejtësisë, përfaqësuesit e Këshillit Prokurorial, Prokurorit të Shtetit dhe Prokurorisë Speciale të Kosovës, kanë lëshuar takimin.

Më poshtë gjeni qëndrimin e sistemit prokurorial, të paraqitur sot para Grupit punues të Ministrisë së Drejtësisë:

"Të nderuar anëtar të këtij grupi punues,

Të nderuar partnerë ndërkombëtarë,

Të nderuar përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë,

Prezenca jonë si përfaqësues institucional të Këshillit Prokurorial të Kosovës, respektivisht Prokurorit të Shtetit, në këtë takim, është shenjë respekti dhe vlerësimi që e kemi për partnerët ndërkombëtarë dhe aktorët e tjerë që janë pjesë e proceseve, të cilët në forma dhe mënyra të ndryshme kanë ndihmuar dhe po ndihmojnë institucionet e vendit, me theks të veçantë ato të drejtësisë.

Siç jeni në dijeni, para tri ditësh, Zëvendësministri i Drejtësisë, z. Blerim Sallahu, i quajti prokurorët të involvuar në veprimtari kriminale dhe piramida kriminale. Një gjuhë kjo e paprecedentë, e papranueshme, liquese dhe jashtë çdo logjike shtetndërtuese dhe institucionale.

Ndaj një gjuhë të tillë, ne kemi reaguar, ku kemi kërkuar distancim të pushtetit ekzekutiv nga deklaratat e tilla. Ky distancim akoma nuk ka ndodhur dhe kjo nuk krijon hapësirë për bashkëpunim ndërinstytucional dhe e minon skajshmërisht respektin e ndërsjellë.



Është e pakuptimtë që ne të flasim në suaza të respektit, kolegjalitetit dhe mirëbesimit me dikë që i quan prokurorët të involvuar në veprimtari kriminale.

Mosdistancimi nga kjo gjuhë nënkupton paragjyqime të atilla që janë krijuar pa bazë dhe janë tendencioze dhe kjo ngritë dilema serioze në qëllimin e vërtetë të sponsorisuesit për të rrënuar pavarësinë institucionale në emër të ndryshimeve dhe reformave ligjore në vazhden e kësaj është dhe drafti i fundit për ndryshimet e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Prandaj, ne nuk do të mund të vazhdojmë të jemi pjesë e këtij grupi, pa një reflektim dhe distancim publik të Zëvendësministrit të Drejtësisë ose pushtetit ekzekutiv.

Andaj, presim një qëndrim dhe reflektim të qartë dhe të bërë publik lidhur me çështjet e ngritura, në mënyrë që të mund të marrin pjesë në këto takime.

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj dhe me kaq përfundon edhe qëndrimi ynë në këtë takim!”.

Sistemi Prokurorial i Kosovës mbetet i përkushtuar dhe i hapur për të bashkëpunuar me të gjithë pa përjashtim, brenda parimeve profesionale, gjithmonë duke e ruajtur ndarjen e pushteteve dhe pavarësinë institucionale dhe në këtë drejtim është thelbësore të ndërtohet besimi i ndërsjellë, të kultivohet një qasje konstruktive, pa paragjyqime dhe e bazuar në objektivitet”.

Fjalimi i Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, me rastin e fillimit të Javës për të Drejtat e Viktimave të Krimit

I nderuar Kryeprokuror i Shtetit z. Aleksandër Lumezi,

Shkëlqesia Juaj, znj. Vjosa Osmani, Presidente e Republikës së Kosovës,



E nderuara Ministre e Drejtësisë, znj. Albulena Haxhiu,

I nderuar Kryetar i Gjykatës Supreme, z. Enver Peci,

Të nderuar ambasadorë dhe drejtues të institucioneve vendore dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare,

Të nderuar kryeprokurorë të prokurorive, prokurorë, avokatë, kryetarë të gjykatave, gjyqtarë, policë dhe ju mbrojtës të viktimave të krimit dhe të pranishëm,

Jam i nderuar që sot jam pjesë e kësaj konference dhe në emër të Këshillit Prokurorial të Kosovës paraqes angazhimet që lidhen me mbrojtjen e viktimave të krimit.

Si kryesues i Këshillit Prokurorial, vlerësoj lart angazhimin e institucionit të Prokurorit të Shtetit dhe Zyrës për Mbrojtjen dhe Ndhimë të Viktimave në misionin e tyre të përditshëm në ndihmë dhe mbrojtje të të gjithë atyre që janë goditur nga krimi dhe njëkohësisht i përgëzoj të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që me punën e tyre ofruan ndihmë dhe mbrojtje në forma të ndryshme për viktimat e krimit.

Mbrojtja e viktimave të krimit është e një rëndësie të veçantë, jo vetëm në aspektin profesional, por edhe në atë human, kur kemi parasysh që efektet e krimit kanë implikime të vazhdueshme emocionale dhe fizike.

Këshilli Prokurorial i Kosovës është angazhuar vazhdimisht për ofrimin e infrastrukturës së nevojshme nënligjore dhe teknike në funksion të mbrojtësve të viktimave dhe do të vazhdojë të ofrojë mbështetjen, duke u bazuar në kompetencat që ka, me qëllim të ngritjes dhe të efikasitetit të punës së të gjithë mbrojtësve të viktimave të krimit.

Në këtë drejtim, pa dyshim, Këshilli Prokurorial i Kosovës do ta ketë prioritet vazhdimin e konsolidimit të mekanizmave institucional, të cilët ofrojnë ndihmë dhe mbështetje për të gjitha viktimat, ashtu që viktimat e krimit të mos harrohen gjatë administrimit të drejtësisë, por të ndihen të sigurt dhe të mbrojtur si në aspektin e fizik ashtu edhe në atë psikologjik. Prandaj, mbrojtja efektive e viktimave të krimit është jetike për një sistem ligjor të drejtë, funksional dhe të mirëfilltë.

Prania dhe roli i prokurorëve nuk do të duhej të shihej vetëm si angazhim simbolik, por, mbi të gjitha, të kenë rol shumë aktiv, i cili përfaqëson fuqishëm interesat e viktimave të krimit, me qëllim që të mos ndjehen të vetmuar dhe pa përkrahje të institucioneve relevante. Prandaj, ndihma dhe mbështetja për viktimat e krimit largon çdo shqetësim të tyre për të panjohurën dhe frikën që kanë për sigurinë e tyre.

Në këtë drejtim, ka rëndësi të madhe edhe njëra nga shtyllat kryesore, me të cilën sistemi i përgjigjet kësaj ndihme dhe mbështetja e tyre është edhe ...kompensimi

për dëmin e pësuar, si formë e ndihmës dhe përkrahjes materiale, shëndetësore, psikologjike dhe sociale.

Procedura penale nuk do të duhej kurrë t'i shtojë vuajtjet e viktimave të krimit, prandaj do të punojmë fuqishëm për të krijuar mekanizma efikas brenda prokurorive të Republikës së Kosovës, me qëllim të mbrojtjes dhe ofrimit të ndihmës për viktimat e krimit.

Në këtë drejtim, përkrahje të madhe në këtë fushë kemi pasur në vazhdimësi nga miqtë tanë ndërkombëtarë, ndaj të cilëve jemi shumë mirënjohës. Në veçanti, vlerësoj lart ndihmën e Ambasadës së SHBA-së në Kosovë, e cila që nga fillimi e deri më sot ka kontribuar në forma dhe mënyra të ndryshme për avancimin e të drejtave të viktimave të krimit.

Në fund, ju bëjë thirrje të gjithëve që të punojmë që çdo rast, çdo viktimit dhe çdo ndjekje penale të trajtohet me dinjitet dhe me kohë. Në këtë mënyrë, ne besojmë shumë se duke mbrojtur viktimat e krimit ndërtojmë një ambient të qetë, të sigurt dhe të shëndoshë për tërë shoqërinë tonë.

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj!

Kryesuesi Maloku priti në takim deputetët nga radhët e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës priti në takim anëtarët e Grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe Ligjit për Procedurën Përmbartimore, grup ky, që është formuar nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete,



Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me ç'rast u diskutua pasqyrimi i sfidave gjatë zbatimit të këtij ligji, në mënyrë që ato të adresohen në kuadër të raportit që do të hartohet nga Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Mbahet punëtori për trajtimin e menaxhimit të punës përmes SMIL-it në sistemin prokurorial

Këshilli Prokurorial i Kosovës, i mbështetur nga Projekti i Bashkimit Evropian (Programi për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë (EUKOJUST)), organizoi një punëtori treditore, ku diskutoi draftin e Rregullores për menaxhimin e proceseve të punës përmes Sistemit për Menaxhimin Informativë të Lëndëve (SMIL), përfshirë



një mori çështjesh procedurale, si: administrimin, menaxhimin, të drejtat e qasjes, kërkimin e të dhënave në SMIL, komunikimin me palët në procedurë, pranimin, regjistrimin dhe shpërndarjen e lëndëve dhe aspekte të tjera pune, të cilat i dedikohen kryekëput funksionimit sa më të mirë të proceseve të punës në sistemin prokurorial.

Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

Sekretariati i KPK-së, gjatë muajit tetor, zhvilloi një konsultë me ekspertët e projektit britanik dhe projektit EUKOJUST për organizimin e punës për nevojat e sistemit prokurorial dhe organizoi trajnimin "Komunikimi i brendshëm administrativ.

Po ashtu përgatiti Raportin financiar janar-shtator 2021 dhe prezantoi versionin e SMIL-it për Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit për lëmin penale, duke filluar nga regjistrimi i lëndëve, shpërndarja e lëndëve dhe veprimet e prokurorëve.

Ndërkohë dorëzoi edhe Raportin për përmbushjen e objektivave në PKZMSA-s dhe ERA-s dhe mbaiti një takim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës për prezantimin e projektit të përbashkët KOSEJ-2 në takimin me përfaqësuesit e Këshillit të Evropës dhe është në proces e sipër të përgatitjes së dokumenti prezantues në Komitetin për Stabilizim Asociim për zhvillimet e fundit të sistemit prokurorial.

SKPK-ja, gjithashtu, mbështeti realizimin e Projektit strategjik "Mbrojtja e votës" për zgjedhjet lokale, më 17 tetor 2021, përmes Dhomës Operative (07-24h) dhe finalizoi komentet e pranuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë për draftin e Projektit

TIK/SMIL në fazën e tranzicionit për periudhën 2022-2024.

Nga ana tjetër, vlen të theksohet edhe mbajtja e takimit me përfaqësuesit e Projektit për Mbështetje të Pronësisë Intelektuale për prezantimin e platformës për regjistrimin e lëndëve të pronësisë intelektuale dhe mbajtja e trajnimit dyditor me temën: “Komunikimi i brendshëm administrativ”.

Gjithashtu ka përfunduar hartimi i Raportit periodik (janar-shtator 2021) për veprat penale karakteristike të Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional dhe ka filluar zbatimin e sistemit elektronik për menaxhimin e dosjeve të prokurorëve përkatësisht moduli i disiplinës.

Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë ka zbatuar aktivitete që kanë të bëjnë me procesin e transferimit të dosjeve të prokurorëve nga NJSHPP-ja te Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe ka filluar hartimin e raporteve për nëntëmujorin e punës së Prokurorit të Shtetit, për harmonizimin dhe përputhshmërinë e shënimeve statistikore të Shkrimores dhe prokurorëve në Prokurorinë Themelore të Gjakovës, për të dhënat për prokurorët e departamenteve për të mitur të prokurorive themelore dhe për mekanizmat e brendshëm të sistemit prokurorial në mbështetje të proceseve të punës.

Ndërkohë, NJSHPP-ja ka përpiluar edhe raportet për ngarkesën e prokurorëve me lëndë dhe efikasitetin në zgjidhjen e tyre sipas llojit të regjistrave: PP, PPM, PPN, PPP dhe NJN për muajin shtator 2021, për statistikat për Trem III, pastaj për veprat karakteristike të mekanizmit përcjellës për harmonizimin e të dhënave statistikore për grupet e veprave penale që kanë të bëjnë me armë, droga, krimin e organizuar, korrupsion, trafikim të qenieve njerëzore, kontrabandë migrantësh, shpëlarje parash, krime ekonomike, sekuestrim dhe konfiskimi i pasurisë dhe raportet e posaçme statistikore për rastet që kanë të bëjnë me raportimet për integritet evropian.

Gjithashtu në mënyrë sistematike janë përcjellë dhe koordinuar trajnimet e zhvilluara në kuadër të Programit të Trajnimeve të Vazhdueshme, si në vijim: trajnimin me temën: “Parandalimi i torturës – Jurisprudencë e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, “Programi i specializuar: shpëlarja e parave dhe hetimi financiar- sesioni III”, “Etika profesionale”, pastaj “Shqyrtimi gjyqësor dhe gjykimi në mungesë”, “E Drejta e Bashkimit Evropian”, “E drejta për jetë private, jetë familjare, të vendbanimit dhe korrespondencës për t’u martuar dhe krijuar familje dhe

për barazi të bashkëshortëve-Neni 8 i KEDNJ-së”, “Financimit i terrorizmit”, “Krimet e luftës”, “Liria e shprehjes-Neni 10 i KEDNJ-së”, “Pjesa e domosdoshme dhe cenimi i saj”, “Dhuna ekonomike” dhe është realizuar punëtorja për “Hartimin e Procedurës Standarde të Veprimit për hetimin e rasteve të punës së rëndë të fëmijëve”.